



Hapet Thirrja për Bursa për stafin akademik të UMT, në Programin Erasmus +, në Universitetin Teknik të Rigës, Letoni

Niveli i mobilitetit:

- Mobilitet për mësimdhënie;

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë stafi akademik i brendshëm në Fakultetin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe IT, stafi akademik në Fakultetin e Ekonomisë si dhe stafi i Fakultetit të Ndërtimit dhe Arkitekturës.

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë (plus 2 ditë udhëtim) dhe përfshin 8 orë mësimdhënie në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor sipas programit Erasmus +, 140 euro në ditë;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës;
- CV dhe listë e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Vërtetim punësimi (në gjuhën angleze);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie;

Afati për aplikim: **23 Tetor, 2022**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: edoku@umt.edu.al

UMT ju uron suksese në aplikimin tuaj!